



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 93-të, të mbajtur më 29.09.2023, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Denoncimi I regjistruar sipas numrit 12-4375/1 të datës 12.09.2023 , kundër Ministrisë -----  
----- të RMV-së, në lidhje me diskriminimin e personit të punësuar, **HIDHET POSHTË**

KSHPK-ja konstatoi se, sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Lënda me numër 12-4375/1 të datës 12.09.2023 të mbyllet dhe të arkivohet

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Më 12 shtator 2023, nga një kërkues i njohur është paraqitur denoncim kundër Ministrisë së -----  
----- të RMV-së në lidhje me diskriminimin e një punonjësi dhe është përcaktuar numri i lëndës 12-4375/1 datë 12.09.2023.

Në denoncim, parashtruesi thekson se kërkon nga KSHPK-ja që të fillojë procedimi kundër Ministrisë së ----- të RMV-së dhe të konstatojë shkeljen e të drejtave nga marrëdhënia e punës që ka pësuar parashtruesi gjashtë herë duke filluar nga periudha 2018/2019 e në vazhdim.

Vendimi i fundit është marrë me të cilin është rivendosur sipas nevojës për kryerjen e detyrave të punës në ----- në -----, i regjistruar me numër -----/1 i -----2023.

Parashtruesi liston të gjitha rishpërndarjet e tij, për të cilat ka dorëzuar vendimet përkatëse për të cilat mendon se është diskriminuar si punonjës i Ministrisë.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, DHPGJS-ja konstaton se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

*Nga sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Dorëzuar :

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: K.Z

Miratoi: Mr. SH:S

**КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОР  
ПЉР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ**  
Kryetar,  
Biljana Ivanovska

---

